

UDHËZIM
Nr. 4381/1, datë 22.9.2015

**PËR TRANSFORMIMIN E KOORDINATAVE NGA KORNIZA REFERUESE
GJEODEZIKE GLOBALE “TTRF2005 (EPOKA 2007.2)” DHE SISTEMI GJEODEZIK
SHQIPTAR “ALB86” NË KORNIZËN REFERUESE GJEODEZIKE EVROPIANE
“ETRF2000 (EPOKA 2014.177)” DHE “ETRF2000 (EPOKA 2008)”**

Bazuar në nenin 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.8.2013, me propozim të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeo-hapësinor, ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike

UDHËZON:

1. Për transformimin e koordinatave nga korniza referuese gjeodezike globale “TTRF 2005 (Epoka 2007.2)” dhe Sistemi Gjeodezik Shqiptar “ALB86” në Kornizën Referuese Gjeodezike Evropiane “ETRF 2000 (Epoka 2014.177)” dhe “ETRF 2000” (Epoka 2008)” të përdoret udhëzuesi i propozuar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe që është pjesë e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), autoritete përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinoe, sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012 dhe çdo institucion tjetër që përdor informacion gjeohapësinor, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN
DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE**
Milena Harito